



REPUBLIKA E KOSOVËS/ REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJAKOVËS  
OPSTINA DJAKOVICA/ MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit

Nr. 07/351/01-19893

Dt. 19.10.2017

Drejtoria për Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit pranë Komunës së Gjakovës duke vendosur sipas kërkesës së aplikuesit: **Enver (Malush) Malazogu** nga Gjakova, për zgjatjen e afatit të Lejes së Ndërtimit të dhënë më parë, për ndërtimin e objektit të dyqanit në kompleksin “Çarshia e Madhe” në Gjakovë, **bazuar në Lejen Ndërtimore - Aktvendimit me numër 09-183-1, të datës 22.09.2000 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm në Gjakovë, në emër të Enver Malazogut, përmes të së cilit është lejuar rindërtimi i objektit – dyqanit, me etazhitet B+P+0, në bazë të Ligjit të Ndërtimit Nr. 04/L-110 neni 21 pika 7, Rregullores mbi rregullat dhe procedurat për planifikim dhe ndërtimin e objekteve në teritorin e komunës së Gjakovës, si dhe Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-031 neni 21, 44 dhe 97, bie këtë:**

## AKTVENDIM

**I. I LEJOHET:** aplikuesit: **Enver (Malush) Malazogu** nga Gjakova, zgjatja e afatit të Lejes Ndërtimore për ndërtimin e objektit të dyqanit në kompleksin “Çarshia e Madhe” në Gjakovë, bazuar në Lejen Ndërtimore të dhënë më parë, sipas Aktvendimit me numër 09-183-1, të datës 22.09.2000 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm në Gjakovë, në emër të Enver Malazogut, përmes të së cilit është lejuar rindërtimi i objektit – dyqanit, me etazhitet B+P+0, në kompleksin “Çarshia e Madhe” në Gjakovë, në rrugën “Izet Hima”, në ngastrën kadastrale me numër 2353/3, ZK: Gjakovë-J-Qytet (gjendja e re pas parcelizimit të ngastrës 2353), bazuar në dokumentacionin e prezentuar (Certifikatës mbi të drejtat në pronën e paluajtshme me nr të lëndës 4394/17, të datës 31.08.2017, Kopjen e Planit të datës 31.08.2017, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë, dhe Planin e Situacionit të datës 11.07.2017.

Bazuar në procesverbalin e Inspektorit të ndërtimtarisë me Nr.14 Nr.354-Ndërtimit, dt.09.06.2017, me rastin e kontrollit në vendin e ngjarjes, si dhe fotot nga vendi i ngjarjes, është konstatuar se në ngastrën me nr. 2353, ZK: Gjakovë - Qytet, investitori deri më tani nuk e ka filluar ndërtimin.

**II. Zgjatja e afatit të lejes së ndërtimit bazohet në Njoftimin mbi lejimin e zgjatjes së afatit të Lejes së Ndërtimit nr. 09-183, i datës 22.09.2000, në emër të Enver Malazogut, i miratuar nga QRTK – Gjakovë, përmes Njoftimit të datës 13.09.2017 dhe Plan Situacionit dhe Projektit kryesor të miratuar nga QRTK-Gjakovë.**

**III. Pjesë përbërëse e dokumentacionit janë siq vijon:**

- Aktvendimin me numër 09-183-1, të datës 22.09.2000 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm në Gjakovë.
- Kopjen e Planit të datës 29.06.2000
- Planin e Situacionit të datës 11.07.2017, i punuar nga N.SH.”GEO STATION” Gjakovë.
- Certifikata mbi të drejtat në pronën e paluajtshme me numër të lëndës 4394/17, të datës 31.08.2017, lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.
- Kopjen e Planit të datës 31.08.2017, të lëshuar nga Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër e Pronë.
- Procesverbalin nga Inspektori i ndërtimtarisë me numër 14.Nr.354 – Ndërtimit, i datës 09.06.2017 si dhe fotot nga vendi i ngjarjes.
- Projektin kryesor të vërtetuar nga QRTK- IMMKG-Gjakovë.

- Vërtetimin mbi kryerjen e obligimeve nga tatimi në pronë, me numër 430/B/595, i datës 17.07.2017.
- IV. Zgjatja e afatit të Lejes Ndërtimore bëhet për periudhën në kohëzgjatje prej një viti nga dita e lëshimit të këtij aktvendimi

## A r s y e t i m

**Enver (Malush) Malazogu** nga Gjakova, me banim në rrugën "Josip Rela" nr. 15, Prishtinë, ka parashtruar kërkesën pranë DUMM me nr.07/351/01-19893 të datës 13.09.2017 për zgjatjen e afatit të Lejes së Lejes Ndërtimore, të dhënë më parë, për ndërtimin e objektit të dyqanit në kompleksin "Çarshia e Madhe" në Gjakovë, bazuar në **Aktvendimin me numër 09-183-1, të datës 22.09.2000 të lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm në Gjakovë, në emër të Enver Malazogut, përmes të së cilit është lejuar rindërtimi i objektit – dyqanit, me etazhitet B+P+0, në kompleksin "Çarshia e Madhe" në Gjakovë, në ngastrën kadastrale me numër 2353/3, ZK: Gjakovë-J-Qytet (gjendja e re), bazuar në dokumentacionin e prezentuar (Certifikatës mbi të drejtat në pronën e paluajtshme me nr të lëndës 4394/17, të datës 31.08.2017, dhe Kopjen e Planit të datës 31.08.2017, të lëshuar nga Drejtoria për Kadastër Gjeodezi dhe Pronë.**

**Vërejtje:** Zgjatja e afatit të Lejes së Ndërtimit, lëshohet duke u bazuar në Njoftimin mbi lejimin e zgjatjes së afatit të Lejes së Ndërtimit nr. 09-183, i datës 22.09.2000, në emër të Enver Malazogut, i miratuar nga QRTK – Gjakovë, përmes Njoftimit të datës 13.09.2017 dhe Plan Situacionit dhe Projektit kryesor të miratuar nga QRTK- Gjakovë.

Pala e ka plotësuar dhe dorëzuar dokumentacionin siq është parashtruar dhe në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

Kompenzimi për obligimet komunale në bazë të Vendimit mbi ndryshimin dhe plotsimin e Rregullores mbi tarifat dhe ngarkesat nga shërbimet dhe veprimtaritë komunale, Neni 5, par. 5.6, e fuqizuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës me 01 Nr.011-43964/2015, është paguar në vlerën prej 30.0 Euro, në PTK, filiali në Gjakovë, sipas dëshmisë së pagesës së datës 27.09.2017.

### KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktvendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 30 ditësh, duke e llogaritur ditën e marrjes në dorëzim. Ankesa i parashtrohet Ministrisë të Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor në Prishtinë, dhe e njëjta dorëzohet nëpërmjet kësaj drejtorie.


Me Aktvendim të njoftohen:

- Parashtruesi i kërkesës,
- Inspektori i Ndërtimtarisë, dhe
- Arkiva.

Zyrtar i Lartë për Çështje juridike

  
Zenel Shabani, jur. i dipl.

U.D. Drejtori,

  
Elida Bejtullahu, inxh.e dipl.e ark.

# PLAN SITUAZIONI

 $P = 1 : 250$ 

Punoi : N.SH "Geo Station"  
Rilevoi: Laxdim Dula

# Kopje plani

ГЛАВНОЕ - ЧИСТ

500

P. SH. KUVENO, KOMUNĚS- BŤAKOVĚ

KUSKËT TËRËN - UEB. PËR OBJ.-DYQAN SIRAS  
STUDIMIT TË REGENERIMIT DHE REVITALIZIMIT  
TË "QARSHIS" SË "KADRE" - GJAKOVË.

9. DOCUMENTATION DES CÉLÉ  
OBJETS CÉLÉ : PERSONNEL



उत्तर

APR. 25 1964

1000000 në fund të vitit 1996

rendor i regjistrit të taksave kadastrale:

305/210

風雨

[illegible]

Kjo kopje e planit është besnike e origjinalit të vet sipas gjendjes në të cilën është e paguar taksën sipas vendimit të KK GJAKOVË.

29.06      sẽ viết 2000

the Gjakovë

**Vērtējam:**

Heck